



Project funded by the European Union

**B | T | D** The Balkan Trust for Democracy  
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Partnerët Shqipëri hap thirrjen për aplikime për eventin "RRATHË DHURUES" (GIVING CIRCLE)



#RrathëDhurues Shqipëri

A keni një ide inovatore që mund të përmirësojë cilësinë e jetës së një komuniteti të caktuar por nuk keni para? Jeni duke zbatuar një nismë konkrete në komunitet por nuk keni burime të mjaftueshme?

**Kjo është mundësia e duhur për ta vënë në praktikë idenë tuaj!**

Partnerët Shqipëri hap thirrjen për aplikime për të gjitha OJF-të që kanë një ide konkrete apo nismë në zbatim për të sjellë ndryshim social në një komunitet të caktuar, përmes mbështetjes edhe nga vetë komuniteti.

Tre idetë më të mira do të përzgjidhen për tu zbatuar duke fituar mbështetje financiare dhe në natyrë përmes një ankandi (live crowdfunding) gjatë eventit "Rrathë Dhurues" i cili do të organizohet për herë të parë në Shqipëri në dhjetor 2018.

## Çfarë është eventin "Rrathë Dhurues"

**Rrathë Dhurues**, është një event i cili mbledh së bashku individë nga fusha të ndryshme duke vënë në dispozicion ekspertizën, kohën dhe burimet financiare për të mbështetur projekte/kauza konkrete por dhe që sjellin ndryshime sociale në komunitete të caktuara. Përmes mbledhjes së bashku me një qëllim filantropik, do të mundësohet mbështetja e tre nismave konkrete duke synuar një transformim pozitiv dhe të qëndrueshëm për individë, komunitete specifike dhe shoqërinë në tërësi.

Partnerët Shqipëri do të zbatojë këtë nismë inovatore sipas komponentëve të mëposhtëm:

- Hapja e thirrjes për aplikime për OJF** të cilat kanë një ide inovative apo nismë konkrete në zbatim për të kontribuar apo ndikuar në komunitete të caktuara;
- Përzgjedhja e 3 ideve më të mira** të cilat synojnë sjelljen e një ndryshimi në komunitetet e targetuara;
- Trajnimi i përfaqësuesve të ideve fituese** për të realizuar një prezantim të suksesshëm gjatë eventit;
- Prezantimi i idesë në event** - çdo ide do të prezantohet dhe do t'ju përgjigjet pyetjeve të audiencës brenda 12 minutave. Mbështetësi i çdo ideje (i përzgjedhur paraprakisht) do të prezantojë qëllimin e mbështetjes dhe do të motivojë audiencën që t'i bashkohet kësaj kauze. Moderatorin e eventit do të ftojë audiencën të dhurojë për secilën nga idetë e përzgjedhura. Dhurimet llogariten live derisa të arrihet shuma e synuar; Shuma e targetuar për secilën ide është minimumi 300,000 lekë.
- Promovimi i ideve të financuara.** Tre idetë e financuara do të promovohen gjerësisht përmes të gjitha kanaleve të komunikimit për të promovuar zbatimin dhe rezultatet e ndërhyrjeve.

### Përse duhet të aplikoni

- Mundësi për promovimin e punës / idesë suaj para një audience të gjerë dhe të zgjedhur;
- Mundësi për tërheqjen e mbështetësve të rinj dhe krijimin e partneriteteve të reja;
- Ka gjithmonë e më pak burime financiare në dispozicion për projekte komunitare;
- Bashkimi bën fuqinë! Nëse të gjithë mbledhen bashkë dhe dhurojnë pak, impakti është më i madh.

### Procesi i Aplikimit

- Thirrja është e hapur për të gjitha OJF-të që kanë një ide inovatore apo nismë në zbatim e sipër që ka qëllim përmirësimin e jetës së komuniteteve të caktuara;
- Kandidatët e interesuar janë të ftuar të aplikojnë duke plotësuar Formën e Aplikimit;
- Afati për dërgimin e aplikimeve është data **13 Korrik 2018**, ora **17:00** në adresën: [jalite@partnersalbania.org](mailto:jalite@partnersalbania.org) ose në zyrën e Partnerëve Shqipëri: **Rr. Sulejman Delvina, N.18, H.8, Ap. 12, ose kutinë postare 2418/1, Tiranë**

### Përzgjedhja

3 idetë fituese që do të marrin pjesë në eventin "Rrathë Dhurues" do të përzgjidhen nga një juri profesionistësh, përfaqësues të sektorëve të ndryshëm.

#### Kriteret e përzgjedhjes:

- Ideja/projekti duhet të zgjidhë një nevojë konkrete dhe të ketë impakt të dukshëm në një komunitet apo komunitete të caktuara;
- Ideja duhet të ketë mbështetjen e komunitetit dhe ta përfshijë atë;
- Çdo aplikant duhet të ketë një mbështetës aktual i cili beson dhe kontribuon financiarisht apo në natyrë (pavarësisht shumës) për idenë.